

SPV Blue 1

Rr. Themistokli Gërmenji,
Ndërtesa 1, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 (0) 4 48 13 427



2384
12.11.24

Nr. SB1_2024_200

Tiranë, më 8/11/2024

Dërgohet: **Komente mbi propozimet për ndryshime të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.**

Drejtuar: **Entit Rregullator të Energjisë (ERE)**
Bulevardi "Bajram Curri", Rruga "Viktor Eftimiu" Nr.1023, Tiranë, Shqipëri

Në vëmëndje: **Z. Petrit Ahmeti**
Kryetar i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)

Për Dijeni: **Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike sha (ALPEX)**
Rruga "Liman Kaba", Rezidenca Olympic, Shkalla 3, Kati 1, Zyra 1, Tiranë, Shqipëri

Në vëmëndje: **Z. Sokol Dishnica**
Administrator i Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike sha (ALPEX)

Nga: **Shoqëria "SPV Blue 1" Sh.p.k.**
Rruga "Themistokli Gërmenji" Ndërtesa 1, Tiranë

I nderuar Z. Ahmeti,

Shoqëria "SPV BLUE 1" sh.p.k. e licencuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) në veprimtarinë e prodhimit, tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, gjithashtu e rregjistruar si palë përgjegjëse balancuese në Tregun Shqiptarë të Balancimit të Energjisë Elektrike, dhe antare e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), operon tregun e energjisë elektrike në zbatim të akteve rregullatore në fuqi. Në vijim të procedurës së konsultimit të publikuar nga ana juaj mbi propozimet e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike për ndryshimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, lutemi si vijon komentet e propozuara nga SPV BLUE 1:

RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE – PROCEDURA E TREGTIMIT		
Seksionet, Paragrafët, Nën-paragrafët	Përshkrimi	
<i>Propozimi i ALPEX</i>	A.2.4. 4	Çdo Urdhërporosi e Thjeshtë mund të përfshijë deri në njëzet e katër (24) segmente për çdo Njësi Kohore Tregu.
<i>Propozimi i SPV BLUE 1 shpk</i>		Çdo Urdhërporosi e Thjeshtë mund të përfshijë deri në 50 Çifte Çmim-Sasi për çdo Njësi Kohore Tregu.
<i>arsyeja</i>	<i>Sipas mendimit tonë Urdhërporosia përmban 50 segmente, por duke qenë se është përdorur koncepti i Çifteve Çmim-Sasi, ne propozojmë që të vendoset ky parashikim.</i>	
<i>Propozimi i ALPEX</i>	B.1.2. 2	ALPEX-i mund të zgjasë Kohën e Mbylljes së Portës së Tregut të Ditës në Avancë për të mbajtur kushte të rregullta tregtimi. Koha e Mbylljes së Portës së Tregut të Ditës në Avancë mund të zgjatet për arsye që lidhen me disponueshmërinë e ETSS-së, Librin e Urdhërporosisë Lokale, si dhe për arsye që lidhen me Ndarjen e Plotë të Tregjeve si dhe parashikimeve të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.
<i>Propozimi i SPV BLUE 1 shpk</i>		ALPEX-i mund të zgjasë Kohën e Mbylljes së Portës së Tregut të Ditës në Avancë për të mbajtur kushte të rregullta tregtimi. Koha e Mbylljes së Portës së Tregut të Ditës në Avancë mund të zgjatet për arsye që lidhen me disponueshmërinë e ETSS-së, Librin e Urdhërporosisë Lokale, si dhe për arsye që lidhen me Ndarjen e Plotë të Tregjeve si dhe parashikimeve të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme.
<i>arsyeja</i>	<i>Sipas mendimit tonë ky parashikim është në Kushtet e Përgjithshme, prandaj duhet përmendur ky dokument.</i>	
<i>Propozimi i ALPEX</i>	B.2.3. 6	ALPEX-i duhet të bëjë një njoftim siç kërkohet në paragrafin Error! Reference source not found. me anë të një Njoftimi për Tregun të dërguar me mjete elektronike në përputhje me pikën C.3.2 të Kushteve të Përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. Forma standarde e këtij njoftimi do të përcaktohet në Vendimin Teknik të ALPEX.
<i>Propozimi i SPV BLUE 1 shpk</i>		ALPEX-i duhet të bëjë një njoftim siç kërkohet në paragrafin Error! Reference source not found. me anë të një Njoftimi për Tregun të dërguar me mjete elektronike në përputhje me pikën C.3.2 të Kushteve të Përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. Forma standarde e këtij njoftimi do të përcaktohet në Vendimin Teknik përkatës të ALPEX.
<i>arsyeja</i>	<i>Qartësim i fjalisë.</i>	

<i>Propozimi i ALPEX</i>	C.1.6.1	Operatori i Bashkimit të Tregut të Ankandëve Brenda së Njëjtës Ditë është përgjegjës për kryerjen e Funkcionit të Operimit të Bashkimit të Tregjeve. Funkzioni i Bashkimit të Tregjeve është një shërbim i ofruar ALPEX-it nga Ofruesi i tij i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve.
<i>Propozimi i SPV BLUE 1 shpk</i>	C.1.6.4	Operatori i Bashkimit të Tregjeve është përgjegjës për kryerjen e Funkcionit të Operimit të Bashkimit të Tregjeve. Funkzioni i Bashkimit të Tregjeve është një shërbim i ofruar ALPEX-it nga Ofruesi i tij i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve.
<i>arsyeja</i>	<i>Në dijeninë tonë, Operatori i Bashkimit të Tregjeve është i njëjtë si për Tregun e Ditës në Avancë edhe për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë.</i>	

SHTOJCA A		
TABELA A.1: SPECIFIKIMET E PRODUKTEVE TË SEGMENTIT TË TREGUT TË DITËS NË AVANCË		
Urdhërporositë në Bllok		
<i>Propozimi i ALPEX</i>	Numri minimal dhe maksimal i çifteve çmim-sasi	Ndërmjet 2 dhe 50, për Urdhërporosi për do Njësi Kohore e Tregut
<i>Propozimi i SPV BLUE 1 shpk</i>	Numri minimal dhe maksimal i MTU-ve dhe i Çifteve Çmim-Sasi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri minimal i MTU-ve në bllok për një portofol është 1 (një) dhe maksimal 24 (njëzet e katër) 2. Një Çift Çmim-Sasi
<i>arsyeja</i>	<i>Sipas Procedura e Tregtimit Urdhërporositë në Bllok kanë vetëm një çmim dhe një sasi. Ne mendojmë që të qëndrojnë parashikimi ynë.</i>	
Urdhërporositë të Lidhura në Bllok		
<i>Propozimi i ALPEX</i>	Numri maksimal i Urdhërporositë në Bllok	Përbëhen nga të paktën dy Urdhërporosi individuale në Bllok
<i>Propozimi i SPV BLUE 1 shpk</i>	Kufizimet lidhur me Urdhërporositë të Lidhura në Bllok	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri maksimal i Urdhërporosive të lidhura në Bllok për Portofol është 5 (pesë). 2. Numri maksimal i Urdhërporosive vartëse të lidhura me një Urdhërporosi udhëheqëse është 4 (katër). 3. Numri maksimal i Urdhërporosive udhëheqëse të lidhura me një Urdhërporosi vartëse është 1 (një).
<i>arsyeja</i>	<i>Sipas hulumtimeve tona në tregjet e tjera, ne mendojmë që ky informacion duhet të jepet në detaje për të pasur më të qartë se si funksionojnë Urdhërporositë e lidhura në Bllok dhe cilat janë kufizimet.</i>	

PËRKUFIZIMET E RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE		
<i>Propozimi i ALPEX</i>		/
<i>Propozimi i SPV BLUE 1 shpk</i>	Çmimi Klerues i Tregut	Nënkupton çmimin e vendosur nga përputhja e Urdhërporosisë Shitjeje të pranuar me çmimin më të lartë me Urdhërporosinë Blerjeje të pranuar me çmimin më të ulët në tregun e energjisë elektrike
<i>arsyeja</i>	<i>Propozojmë të mos fshihet si përkufizim pasi përdoret shpesh gjatë Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.</i>	

Mbetemi të hapur për çdo sqarim të mëtejshëm, duke shpresuar se propozimi ynë do të merret në konsideratë prej jush, ju falenderojmë për bashkëpunimin,

Me respekt,

ADMINISTRATORI

ZENEL HYSENBEGASI

Zenel Hysenbegasi

